

FJALA E DEPUTETES FLUTURA AÇKA

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Nga valë që nuk i kuptoj as vetë, na ndodh të jemi përballë bashkë deri tani, ndoshta, çështje bioritmi, kur të tjerët kanë kryengritje në stomak, ne duhet të punojmë. Shumë mirë! Kam bërë një kërkesë për procedurë më parë dhe zonja Kryetare nuk ma dha fjalën, prandaj, po jua kërkoj juve. Çështjen e diskutimit e kisha në lidhje me fyerjet që janë bërë sot në parlament. Unë jam pjesë e Sekretariati të Etikës dhe, për etikë, do t'i bëja një vërejtje publike zotit Kryeministër: këtu nuk jemi për të bulizuar shokët dhe kolegët, por për t'u sjellë si politikanë dhe shtetarë të rregullt. Meqenëse nuk e bëra dot vërejtjen publike, do ta bëj me shkrim në Sekretariat. Sigurisht që do të talleni, por unë do të bëj detyrën time këtu në parlament edhe ndaj qytetarëve shqiptarë. Duket që Kryeministri ka një inventar të plotë të balonave dhe të satelitëve që vërtiten nëpër qiell, por ai nuk ju tha një gjë: në qiell vërtiten edhe balona ajri të zbrazura, që ndonjëherë shoqërohen edhe me një karkas të zbukuruar me tullumbace (zakonisht kur ka festë, siç është kjo festa e sotme e buxhetit), dhe që të ngjiten në ajër duan gaz, tym e nxehtësi. Se çfarë ajri dhe gazi e mban Kryeministrin në këmbë, që nuk na rrëzohet këtu në foltore, duke aktruar, tashmë është legjendë urbane në Tiranë. Prandaj po vazhdoj me temën time.

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Kisha menduar të flisja për gjëra të tjera, por, për shkak të një ngjarjeje kulturore shumë të rëndësishme këtë javë, siç është Panairi Kombëtar i Librit, po e ndryshoj. Sigurisht, ajo që dua të them është në funksion të taksave, të buxhetit. Pak ditë më parë në këtë foltore, njëfarë artisti, i cili nuk menaxhon dot as gjatësinë e vet dhe jo më fatin dhe shtetin tuaj, u tall me njerëzit që merren me zejen fantastike të letërsisë. Këta, veçmas ata njerëz që merren me letërsi dhe me përkthime letrare, nuk kanë mundësi të bëjnë thagma në këtë vend të varfër, por të paktën ua bëjnë pak orë më të lehtë jetën shqiptarëve me lexime, duke i ndihmuar të harrojnë kush i drejton dhe se si po i drejton. Për këta njerëz dua të flas sot, jo për artin e tyre, sepse kjo ngrehinë hipokrite do përkthim për ta bërë këtë, por për mbijetesën dhe rropatjen e tyre për ta ruajtur këtë zeje të bekuar, në kushtet e një politike agresive dhe të një mjedisi aspak bujar për ta. Minutat nuk më japin mundësinë ta shtjelloj gjatë buxhetin, edhe pse nëpër komisione jam përpjekur ta bëj këtë, por do të mbetem tek tatimet mbi të ardhurat dhe honorarët e këtyre njerëzve, për të cilët po flas, zë që në buxhet as që përmendet fare. Sa i japin ata këtij vendi? Sa marrin ata prej nesh? Sa të ardhura derdhin? Sa do të humbin, nëse ua kursejmë këto detyrime tatimesh e kësidoresh, krahasuar me punën vetëmohuese të tyre krijuese? E përsëris po flas për krijimin artistik, i cili paguan 15 % tatim në burim për çdo cent honorar të marrë. Në përvojën e gjatë në këtë fushë, më ka ndodhur që nga zori ta paguaj vetë këtë vlerë, pasi aq qesharake janë pagesat e përkthyesve të librit artistik te ne, sa që detyrohesh dhe vihesh në pozitë. Disa prej përkthyesve më të mirë që me vite i kam zbuluar, i kam mbështetur, i kam kuruar, i kam propaganduar dhe i kam botuar, tashmë e kanë braktisur Shqipërinë.

Të tjerë të talentuar që njoh, po i bëjnë gati valixhet. Nuk flas këtu për mbështetjen që duhet t'u bëjmë përkthyesve të huaj, që kontribuojnë për kulturën shqiptare, sepse ata nuk i kemi në asnjë listë. Mjafton t'ju them se shteti shqiptar nuk i dhuroi kurrë, qoftë edhe një biletë avioni, ambasadorit më të rëndësishëm të kulturës shqiptare, tashmë i ndjerë, Robert Elsie-s. Nuk po flas për mbështetjen e përkthyesve tanë në diasporë, të cilët me pak kujdes nga ne do të plotësojnë një hendek të madh të krijuar tashmë nga përkthyesit e larguar. Nuk po flas për krijimin e një fondacioni të letrave shqipe që të jetë i pavarur dhe nën kujdesin e këtij parlamentit, që të mos i ndajmë shkrimtarët e përkthyesit në

blu dhe mavi, sepse ky është luks i madh për ne, po flas thjesht për uljen e tatimit në burim të këtyre pak njerëzve që na kanë mbetur. Jo se kështu do t'i mbajmë me zinxhirë që të mos ikin, por të paktën t'u japim të kuptojnë se e vlerësojmë produktin e tyre shpirtëror. Me një llogari të thjeshtë nga ana ime, nisur nga mesatarja e veprave artistike të botuara në 5 vjetët e fundit, nga pagesat e honorarëve të mundshëm të bazuar në shitjet e autorëve vendas dhe pagesat e honorarëve të përkthimit të veprave artistike, shuma që buxheti humb në vit kam bindjen se nuk shkon më shumë se 1 milion e gjysmë- 2 milionë euro.

Kjo shumë është në korrelacion me ngritjen që ju i bëtë tatimit të honorarëve nga 10 % në 15 %, kur erdhët në pushtet. E di që do të më thoni se ndryshime të tilla prishin balanca, jo po duhet studiuar zinxhiri i varësisë, të shihen efektet, jo po kjo, jo po ajo. Nuk hahen e nuk jetohet me termat financiarë e me shpjegime bjerraditëse. Ka vendime akute për nevojat akute. Dhe unë po ju bëj thirrje sot, para se të na vijë turp nesër, se kjo është një nevojë akute dhe e dinjitetshme për një shpurë të nderuar njerëzish që punojnë pa bujë dhe plot pasion. Autorët dhe përkthyesit paguajnë 15 % të tatimit në burim për honorarët e tyre, njëlloj siç tatonen të ardhurat nga lojërat e fatit, kazinotë apo qiratë. Është e qartë se me çfarë i krahasojmë këta njerëz! Kjo është arsyeja pse shumë prej tyre në orët e natës punojnë roje kazinoje apo në call center-at e ngritur si kërpudha këtejpari. Nuk do shumë për ta kompensuar këtë shumë, mjafton të vini pak rregull në koncertet e tallavave të këngëtarëve, të cilëve nëpër dasma e koncerte, madje edhe në mitingjet politike, u shkon nata mbi 2000 euro, shumë që do ta trondiste llogarinë e një shkrimtari shqiptar që ka vendosur të jetojë me krijimtarinë e tij. Me këtë nuk po kërkoj lëmoshë për shkrimtarët dhe përkthyesit e shkrimtarëve, por po kërkoj dinjitet, të cilin duket se të gjallët as e kanë në mend. "Që ta kuptosh një poet apo një artist dhe ta krahasosh me të tjerët, duhet ta vendosësh atë mes të vdekurve", thotë Tomas Eliot diku. Poet ishte edhe ky dhe u mor me nja dy akademi, ku më së paku studioi latinishten dhe greqishten e vjetër, përpos ca gjuhëve të tjera të kohës së tij.

E nderuar zonja Ministre e Financave,

Ju sjell në vëmendje kaosin që krijoi vendosja e TVSH-së nga paraardhësit tuaj për librin në 6 % vetëm 24 orë përpara se të gdhijej 1 janari i vitit 2020, pa llogaritur 20%-shin e TVSH-në për shtypshkronjat, ku me një të rënë të lapsit u futën në një thes shtypshkrime e libra me pretekstin: "Nuk e ndanim dhe nuk i kontrollonim dot". Sigurisht, u duk sikur kjo ishte eksperimentale dhe zgjati vetëm disa muaj, por i krijoi një tronditje tregut të librit, nga e cila ende nuk e ka marrë veten. Nuk është aq e rastësishme që mes mallrave dhe shërbimeve kulturore të vitit 2020 zëri i librit e ka rritjen më të lartë të çmimit në 2,1 %. Edhe indeksi i harmonizuar i çmimit, në krahasim me fundin e vitit 2015, është rritur nga 100 në 113,3 për vitin 2019 dhe në 115,7 për vitin 2020, tendencë që ka shoqëruar edhe vitin 2021. Që të mos e dramatizoj edhe më "tokën e shkretë" të Eliotit, po përpiqem të justifikohem edhe unë, sikurse bëni ju në të gjitha fjalimet tuaja, se prej "plagëve" të Covid-19 dhe tërmetit në vitin 2020 u botuan plot 1550 vepra letrare më pak dhe do të ketë edhe më pak këtë vit, nëse sot nuk bëni një gjest "rilindës"; të asaj "Rilindjes" së parë e kam fjalën, "Rilindjes" patriotike që bëri komb në këtë vend. T'ia ulim barrën e shpinës së thyer kulturës shqiptare dhe fillojeni këtë me uljen e tatimit për honorarët e autorëve dhe përkthyesve, që ata të vazhdojnë të na magjepsin me produktet e tyre shpirtërore. Faleminderit!